

**L I G J**  
**Nr.8463, datë 10.3.1999**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E VJENËS “PËR MBROJTJEN E SHITESËS SË OZONIT” DHE PROTOKOLLIN E MONTREALIT “PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHITESËN E OZONIT”**

Në mbështetje të neneve 121 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Vjenës “Për mbrojtjen e shtresës së ozonit” dhe në Protokollin e Montrealit “Për substancat, që hollojnë shtresën e ozonit”.

Neni 2

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit të mbulojë detyrimin financiar vjetor të Republikës së Shqipërisë, detyrim që i lind vendit tonë si palë në këtë konventë dhe në këtë protokoll.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2338, datë 19.3.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**